



ILLYRIAN GUARD SH.A.

Nr. 411 Prot.

Tiranë, më 03 .2022

Lënda: Njoftim për kontraktim Ekspert në fushën e Inxhinierisë Tekstile dhe Lëkurës

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
Adresa: Sheshi Nënë Tereza, Tiranë

TIRANË

Të nderuar,

Shoqëria "Illyrian Guard" ShA në mbështetje të Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në RSH", i ndryshuar, të nenit 74 dhe 75 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr.177, datë 04.04.2019 "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë "Illyrian Guard ShA" dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", kërkon të kontraktojë me kontratë shërbimi: Një ekspert në fushën e inxhinierisë tekstile dhe lëkurës.

Shoqëria "Illyrian Guard" ShA ka publikuar në faqen e Webit <https://illyrianguard.al/njoftim-per-kontraktim/> thirrjen për paraqitjen e aplikimeve nga personat e interesuar.

Lutemi njoftimin nga ana Juaj të stafit Tuaj mbi thirrjen e publikuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

ADMINISTRATOR

Robert LILI





MARCH 25, 2022

Njoftim për kontraktim

NJOFTIME

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në RSH", i ndryshuar, të nenit 74 dhe 75 të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr. 177, datë 04.04.2019 "Për krijimin dhe funksionimin e Shoqërisë "Illyrian Guard ShA" dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", Shoqëria "Illyrian Guard" ShA kërkon të kontraktojë me kontratë shërbimi: Një ekspert në fushën e inxhinierisë tekstile dhe lëkurës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët:

Eksperti që do kontraktohet do kryejë detyrat e mëposhtme:

1. Konceptimin e specifikimeve teknike dhe modelin e elementëve për uniformën e shërbimit bazë si më poshtë:

- Kapele me rreth rumbullak dhe të branduar me logo të Illyrian Guard,
- Pantallona (verore dhe dimërore)
- Xhakovento për përdorim në pranverë dhe vjeshtë
- Mushama me mëngë për mbrojtje nga shiu
- Këpucë jotaktike
- Stemë krahu me logo dhe shkrim Illyrian Guard
- Numër identifikues
- Stemë supi (spateta)

2. Konceptimin e specifikimeve teknike dhe modelin e elementëve për uniformën civile për t'u me elementë si më poshtë:

Privacy - Terms

- Kostum civil (xhaketë, pantallona)
- Këmishë me mëngë të shkurtra dhe të gjata
- Kravatë
- Këpucë model klasik
- Trequart
- Shall me logo Illyrian Guard

3. Konceptimin e specifikimeve teknike dhe modelin e elementëve për uniformën e shërbimit operacionale, si më poshtë:

- Bluzë Polo me mëngë të shkurtra
- Pulovër me jakë gjysëm golf
- Skafandër (kokore)
- Këpucë taktike për motorristë
- Doreza
- Jelek multifunksional

KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT:

1. Kriteria të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë;
- Të mos jetë në hetim dhe në proces gjykim;

2. Kriteria të posaçme

- 2.1 Të ketë përfunduar studimet universitare në fushën e inxhinierisë tekstile;
- 2.2 Të ketë eksperiencë pune minimumi 5 (pesë) vite në fushën e kërkuar;
- 2.3 E preferueshme të ketë certifikime pasuniversitare në fushën e inxhinierisë tekstile;

3. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të aplikimeve

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- 3.1 Kërkesë me shkrim për aplikim;
- 3.2 Jetëshkrimin (CV);
- 3.3 Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- 3.4 Kopje e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në Ministrinë e Arsimit (për diplomat e marra jashtë vendit);
- 3.5 Kopje e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose vërtetime për punët e kryera;
- 3.6 Vërtetim i gjendjes gjyqësore;

➤ Kandidatët duhet të paraqesin dokumentat e mësipërme brenda datës 07.04.2022 nëpërmjet postës zyrtare të Shoqërisë "Illyrian Guard" me adresë: Rruga Ibrahim Rugova (Ish Garda e Republikës së Shqipërisë, Tiranë).

➤ Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen për zhvillimin e intervistës me gojë.

Njoftim për vend të lirë pune

Illyrian Guard



Illyrian Guard vjen si një alternativë në treg, e cila garanton profesionalizëm,

Rreth nesh

[Historia dhe Filozofia](#)

[Struktura Organizative](#)

Shërbimet tona

[Kërko Shërbim](#)

[Support i Shpejtë](#)